



**KOMUNA E PRISHTINËS**  
**RAPORT MUJOR**

Drejtoria	Drejtoria e Kadastrit
Periudha raportuese	<b>Dhjetor 2016</b>
Emri dhe mbiemri i raportuesit	Nora Kelmendi, drejtoreshë e Drejtorisë së Kadastrit

**1. PËRMBLEDHJE - Përmbledhje e përgjithshme rreth mbarëvajtjes/ecurisë së punës në drejtorinë tuaj për muajin raportues.**

Drejtoria e Kadastrit - Zyra kadastrale komunale (ZKK) e Prishtinës, ka vazhduar të bëjë ofrimin e shërbimeve sa më efikase për qytetarë, duke ofruar informacione dhe të dhëna të azhurnuara për pronat e paluajtshme.

Gjatë muajit dhjetor 2016, në 6 zyrat pritëse janë pranuar gjithësejt **3,137** kërkesa, nga të cilat janë miratuar **2,970** kërkesa, refuzuar **51** dhe kanë mbetur në procedurë **117** kërkesa, të cilat janë realizuar përmes 2 sektorëve: Sektorit të kadastrit dhe Sektorit të gjeodezisë.

**2. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA - Listoni aktivitetet për muajin raportues të parapara me plan programin e Komunës për drejtorinë tuaj .**

Aktivitetet e planifikuara të DK-së janë:

- Shqyrtimi i kërkesave për regjistrim të pronësisë;
- Shqyrtimi i kërkesave për regjistrim dhe çregjistrim të hipotekës;
- Shqyrtimi i kërkesave për përmirësim të regjistrave kadastrale;
- Shqyrtimi i kërkesave për regjistrim të banesave;
- Shqyrtimi i kërkesave/ankesave të palëve dhe institucioneve;
- Shqyrtimi i kërkesave për ndarje të pronësisë, parcelave;
- Shqyrtimi i kërkesave për dhënie të produkteve (koordinatave);
- Shqyrtimi i kërkesave për bashkim të parcelave;
- Shqyrtimi i kërkesave për identifikimin e njësisë banesore;

- Shqyrtimi i kërkesave për përcaktim dhe rirregullim kufiri;
- Shqyrtimi i kërkesave nga gjeodetët dhe kompanitë e licensuara;
- Shqyrtimi i kërkesave/ankesave të palëve dhe institucioneve.

**3. *AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA - Listoni dhe shpjegoni aktivitetet e implementuara gjatë periudhës raportuese nga drejtorja juaj duke përfshirë edhe aktivitetet që janë në implementim e sipër. Theksoni të arriturat e drejtorisë.***

Në Drejtorinë e Kadastrit në Prishtinë gjatë muajit dhjetor 2016, përmes zyrave pritëse dhe 2 sektorëve, janë pranuar kërkesa të ndryshme, prej të cilave:

**Në sektorin e kadastrit janë përpunuar kërkesat në vijim:**

- 298 kërkesa për regjistrim të pronësisë, prej të cilave janë miratuar 175, refuzuar 51 kërkesa për regjistrim të pronësisë, ndërsa janë njoftuar palët në procedurë me 72 konkluzione, duke u pezulluar procedura deri në plotësimin e lëndëve me dokumentacione përkatëse;
- 19 kërkesa për historik nga persona fizikë, institucione, ku janë miratuar të gjitha;
- 375 shkresa – kërkesa nga institucionet e ndryshme, ku janë realizuar të gjitha.
- 207 kërkesa për përmirësime, ku janë miratuar të gjitha;
- 47 kërkesa për përmirësime në RDPP, nga të cilat janë miratuar 13 dhe kanë mbetur në procedurë edhe 34 kërkesa;
- 3 kërkesë për regjistrim të barrës tatimore, e cila është miratuar;
- 55 kërkesa për regjistrim të hipotekave, të gjitha të miratuara, dhe 35 kërkesa për çregjistrim, ku janë miratuar të gjitha.

**Në Sektorin e gjeodezisë janë përpunuar kërkesat në vijim:**

- 1,022 kërkesa për certifikata të pronësisë dhe 879 kërkesa për kopje të planit, e që në total janë pranuar dhe realizuar 1,901 kërkesa;
- 8 kërkesa për ndarje të pronësisë, ku janë miratuar të gjitha;
- 5 kërkesa për bashkim të parcelave, të miratuara të gjitha;
- 53 kërkesa për dhënien e produkteteve (koordinatave) , të realizuar të gjitha;
- 58 kërkesa për identifikimin e njërive banesore, nga të cilat janë aprovuar 54 dhe 4 kërkesa kanë ngelur në procedurë për shqyrtim;
- 9 kërkesa për përcaktim dhe rirregullim kufiri, nga të cilat janë miratuar 8 dhe 1 kërkesë ka mbetur në procedurë për shqyrtim.

- 1 kërkesë për ndërrim kulture, në procedurë;
- 48 kërkesa nga gjeodetët dhe kompanitë e licencuara, nga të cilat janë aprovuar 43 dhe 5 kërkesa kanë ngelur në procedurë për shqyrtim;
- 15 kërkesa zyrtare për përmirësime nga palët dhe kërkesa zyrtare nga institucionet, si: Ministria e Planifikimit Hapësinor, Drejtoria e Urbanizimit, Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP), Agjencia Kosovare e Pronës (KPA) etj., ku janë miratuar të gjitha.

Nga të dhënat e lartshënuara, shihet se Drejtoria e Kadastrit ka implementuar rreth **90 %** të planit të saj, duke i miratuar, refuzuar apo pezulluar kërkesat e palëve në procedurë, sipas shqyrtimeve ligjore që ka bërë lidhur me këto kërkesa.

E arritur e kësaj Drejtorie është që në afatin e përcaktuar ligjor prej 15 ditëve, ka arritur të nxjerrë vendime meritore për secilën prej kërkesave të parashtruara nga palët /subjektet juridike.

#### ***4. AKTIVITETET NË IMPLEMENTIM E SIPËR - Të përshkruhen në detaje aktivitetet që janë në implementim e sipër nga drejtoria juaj për muajin raportues.***

Aktivitetet që janë në implementim e sipër nga Sektori i kadastrit:

- Lëndët në shpallje publike në afat prej **5** ditë punë, që kanë të bëjnë me regjistrimin e pronës së paluajtshme në operatin kadastral;
- Lëndët e dërguara në KPA, verifikim dhe pëlqime për regjistrim të banesave;
- Lëndët e dërguara për verifikim në gjykata, Arkiv Komunal ose Ndërkomunal.

Aktivitetet që janë në implementim e sipër nga Sektori i gjeodezisë:

- Lëndët për ndarje, identifikim dhe bashkim të parcelave;
- Lëndët për identifikimin e njërive banesore;
- Lëndët për kërkesa zyrtare dhe kërkesa nga institucionet;

**4.1.1. STATISTIKAT-Të listohen te gjitha statistikat përkatëse për drejtorinë tuaj, duke filluar nga buxheti e planifikuar dhe shpenzuar për periudhën raportuese, diskutimet publike, takimet me palë, institucione, qytetarë e të ngjashme, kërkesat për qasje në dokumente zyrtare, lëndët e pranuar, kryera dhe në përfundim e sipër, dhe statistika tjera specifike që mund të këtë drejtoria juaj. Shtoni kategoritë sipas nevojës.**

<b>Kërkesat e pranuar në Drejtorinë e Kadastrit, dhjetor - 2016</b>	<b>Numri total i kërkesave</b>	<b>Të miratuar</b>	<b>Të refuzuar</b>	<b>Në procedurë</b>	<b>Mjetet e grumbulluar a €</b>
Certifikata të pronësisë dhe kopje të planit	1,901	1,901	0	0	9,770
Kërkesa për RDPP (regjistrimi i të drejtës për pronë të paluajtshme)	298	175	51	72	11,570
Kërkesa zyrtare për historik dhe kërkesa nga persona fizikë dhe juridikë për historik	19	19	0	0	180
Kërkesa nga institucione të ndryshme dhe përgjigjet nga Gjykata dhe institucione të tjera - Shërbimi i RDPP-së	375	375	0	0	29
Kërkesa të tjera: përmirësime, ankesa, plotësim të lëndëve etj.	207	207	0	0	390
Përmirësime në RDPP	47	13	0	34	940
Barra tatimore	3	3	0	0	30
Kërkesat për regjistrim të hipotekave	55	55	0	0	8,940
Kërkesat për çregjistrim të hipotekave dhe ndryshime	35	35	0	0	590
Ndarjet - parcelimet, copëtimet	8	8	0	0	2,378
Bashkimi i parcelave	5	5	0	0	280
Dhënia e produkteve - pikave kadastrale (koordinatave)	53	53	0	0	1,200
Identifikimi i parcelave dhe njësisive banesore	58	53	0	5	1,300

Përcaktimi dhe rirregullimi i kufirit të parcelave	9	9	0	0	495
Ndërrim i kulturës	1	0	0	1	1,499
Kërkesat me licencë	48	43	0	5	2,378
Kërkesa zyrtare nga institucionet - Shërbimi i gjeodezisë	15	15	0	0	50
<b>Totali</b>	<b>3,137</b>	<b>2,969</b>	<b>51</b>	<b>117</b>	<b>42,019</b>

#### 4.1.2 Buxhetin e planifikuar dhe shpenzuar për periudhën raportuese

Drejtorja e Kadastrit nuk shpenzon buxhet për të regjistruar të drejtat pronësore në regjistrat kadastralë, përkundrazi, kjo drejtori realizon të hyra nga taksat e qytetarëve.

#### 4.1.3 Takimet me palë

- **Sektori i kadastrit** - gjegjësisht Zyra për regjistrimin e pronës së paluajtshme (RDPP), ka takime të rregullta me palë dy herë në javë (*të martave dhe të enjteve*) nga 2 orë në ditë, me dy zyrtarë ligjorë, ku ofrohen këshilla për plotësim të lëndëve sipas kërkesave të palës. Brenda këtyre 2 ditëve, 2 zyrtarët e Zyrës për RDPP takohen me rreth 351 qytetarë.
- **Sektori i gjeodezisë** - ka takime të rregullta me palë. Gjatë muajit shtator 2016, ka pranuar 205 palë për plotësim të lëndëve sipas kërkesave të tyre për ndarje, bashkim ose rregullim kufiri. Po ashtu, ka takime me palë për identifikimin e banesave, si dhe takime të tjera me palë sipas kërkesave të tyre lidhur me çështjet pronësore.

#### 5. Takimet me institucione të tjera

- **Sektori i kadastrit** - Takim me qytetarët për çështje të ndryshme kadastrale pronësore, për të cilat kemi zgjidhje ligjore ose i kemi udhëzuar palët që t'u drejtohen institucioneve tjera në vend. Takim me AKP-në për disa përgjigje të kthyer nga kjo agjenci.

**5.1.1 Diskutime publike /takime me qytetarë**  
- Nuk kemi pasur.

**6. Kërkesat për qasje në dokumente zyrtare**

**6.1.1 Lëndë të pranuar, të kryera dhe në përfundim e sipër**

- **Spektori i kadastrit:**

- Lëndë të pranuar: 1,039
- Lëndë të miratuara: 882
- Lëndë të refuzuara: 51
- Lëndë në procedurë: 106

- **Spektori i gjeodezisë:**

- Lëndë të pranuar: 2,098
- Lëndë të miratuara: 2,087
- Lëndë të refuzuara: 0
- Lëndë në procedurë: 11

**7. Takime të tjera**

*Nuk kemi pasur.*

**8. SFIDAT - Nëse gjatë implementimit të planeve është hasur në vështirësi të ndryshme, psh. pengesa brenda drejtorisë, komunës apo institucioneve të ndryshme, ju lutëm shpjegoni në këtë hapësirë.**

**Spektori i kadastrit:**

- Sfidues është komunikimi me institucionet, moskthimi i përgjigjeve në afate ligjore, të cilat na krijojnë probleme me palë dhe përfaqësues të palëve;
- 4 kërkesa presin për verifikim në Arkiv Komunal dhe Ndërkomunal;
- 98 kërkesa presin për verifikime në Gjykatë;
- 21 kërkesa presin për verifikime në privatizim;
- 20 kërkesa presin për verifikime në NPB;
- 16 kërkesa presin për verifikime në KPA;
- 2 kërkesa presin për verifikime në Drejtorinë e Financave dhe Pronës.

**Spektori i gjeodezisë:**

- Sfidues është komunikimi me Agjencinë Kadastrale të Kosovës, moskthimi i përgjigjeve në lidhje me problemet që hasim çdo ditë me programin “Cadastral Map” dhe “SITK”, të cilat na krijojnë probleme me palë dhe përfaqësues të palëve;
- Mungesa e shënimeve në pjesën grafike, gabimet të cilat janë krijuar me rastin e rikonstruktimit të disa zonave kadastrale nga Agjencia Kadastrale e Kosovës.

**9. REKOMANDIME - Shënimi rekomandime rreth përmirësimit të mbarëvajtjes së proceseve nëse keni dhe nevojave të drejtorisë për të gjitha aspektet, p.sh. trajnime të punëtorëve, furnizim me pajisje shitesë, etj.**

**Spektori i kadastrit:**

- Trajnime për punëtorë sa i përket administratës dhe funksionimit të saj.

**Spektori i gjeodezisë:**

- Trajnime për punëtorë sa i përket aplikimit të Kornizës së punës.

**10. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA PËR MUAJIN PASUES -Listoni aktivitetet e planifikuara për drejtorinë tuaj për muajin pasues**

**Spektori i kadastrit:**

- Lëndët në shpallje publike në afat prej 5 ditë pune;
- Lëndët në KPA për pëlqime për regjistrim të banesave;
- Lëndët për verifikim në gjykata, NPB, AKP, Arkiv Komunal ose Ndërkomunal;

**Spektori i gjeodezisë:**

- Shqyrtimi i kërkesave për ndarje të pronësisë;
- Shqyrtimi i kërkesave për dhënie e produkteve (koordinatave);
- Shqyrtimi i kërkesave për bashkim të parcelave;
- Shqyrtimi i kërkesave për identifikimin e njërive banesore;
- Shqyrtimi i kërkesave për përcaktim dhe rirregullim kufiri;
- Shqyrtimi i kërkesave për gjeodetët apo kompanitë e licencuara;
- Shqyrtimi i kërkesave/ankesave të palëve dhe institucioneve.

**11. TË TJERA - Shënimi çështjet tjera që mendoni se janë me rëndësi të raportohen e që nuk kanë qenë të përfshira në pikat e mësipërme**

- Më 02.12.2016, është bërë dorëzimi dhe pranimi i projektit “Incizimi gjeodezik i hapësirave të përbashkëta banesore” në Prishtinë (me numër të prokurimit: 616 16 122 221). Me anë të këtij projekti është bërë inçizimi gjeodezik i hapësirave të përbashkëta banesore në 71 objekte kolektive të banimit dhe është realizuar në këto lagje: “Ulpiana” - 18.08 %, “Dardania” - 16.92% dhe zona “Qendër” - 4.54 %.